



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:131486

Datë: 24.12.2024

Numri i dokumentit: 06645520

C.nr.5689/24

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N. F., me numër personal ..., të cilin sipas autorizimit përfaqëson B. P., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme, në Prishtinë, Rruga "Luan Haradinaj" p.nr, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, me objekt kontesti, kompensim i pagës së 13 (trembëdhjetë), jashtë seancës gjyqësore me datë 20.12.2024, jep këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpapia e paditësit N. F., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë, që paditësit t'ia kompensoj në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjeta për fund vitin 2022, shumën prej 663.52 €, me kamatën ligjore prej 8 % në vit, e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive.

II. Secila palë bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes përfaqësuesit të tij, me datë 02.05.2024, ka paraqitur padi, kundër të paditurës, për kompensimin e pagës së trembëdhjetë, duke theksuar se paditësi është i punësuar tek e paditura dhe meqenëse e paditura nuk ka përmbushur obligimin e saj në lidhje me kompensimet e lartcekura të cilat rrjedhin nga Udhëzimi Administrativ Nr.01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, ka kërkuar nga që paditësit në emër të shpërblimit të një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit 2022, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 663.52 €, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, e cila fillon të llogaritet nga data kur është paraqitur papia në këtë gjykatë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes - pranimi të njëjtë, nën kërcënimin e përmbarimit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura me datë 21.11.2024, ka parashtruar përgjigje në padinë me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetim se kompensimet e pagës së trembëdhjetë nuk janë realizuar për asnjë punonjës të Policisë së Kosovës, për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Ka shtuar se Ministria e Financave në përputhje me nenin 19 të Ligjit nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, përkatësisht Ligjin nr. 05/L-125, neni 20 paragrafi 4 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës dhe si rrjedhojë, çdo nismë, duke përfshirë edhe atë lidhur me nenin 30 të UA nr.02/2018 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare nuk është i obligueshëm përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore – financiare nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së 13-të. Ka shtuar se bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 është theksuar se “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh”, duke shtuar se kërkesëpadia e paditësit ka arritur parashkrimin. Andaj i ka propozuar Gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, që në këtë rast rezulton se padia e paditësit është e pa bazuar për arsye se:

Me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) përcaktohet se: “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia*”.

Bazuar në shkresat e lëndës dhe atë nga vërtetimi i datës të datës 11.05.2023, me numër ... vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune me të paditurën nga data 17.01.2005 dhe se i njejtë në momentin e lëshimit të vërtetimit në fjalë, ka realizuar pagën mujore në lartësi prej 663.52 €, fakte të cilat nuk u kontestuan nga e paditura me përgjigjen në padi.

Fakti vendimtar për tu vlerësuar nga ana e Gjykatës në këtë çështje juridike kontestimore, konsiston në vlerësimin e mundësisë së aplikimit të nenit 30 paragrafi 2 të UA nr.01/2021 ku përcaktohet se: “*Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse ka mjete buxhetore*”, gjegjësisht nëse ekziston mundësia buxhetore e të paditurës për të kompensuar pagën e 13-të punëtorëve të saj, për fundvitin 2022.

Çështja e kompensimit të pagës së 13-të për çdo vit kalendarik, është e përcaktuar me dispozitën nga neni 30 par.2 të Udhëzimit të lartëcekur, ku nga interpretimi i të njejtës, rezulton se kompensimi i kërkesës për pagën e trembëdhjetë për fundvitin 2022, është e normuar si detyrim i karakterit jo obligativ apo alternativ, gjegjësisht i kushtëzuar varësisht mundësive buxhetore tek e paditura, që nënkupton se e drejta e paditëses për të realizuar një kompensim të tillë nga marrëdhënia e punës është thelbësisht e lidhur nga mundësitë buxhetore të punëdhënësit

këtu të paditurës. Për një interpretim të tillë, kjo gjykatë iu referua edhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, GJ.A.Su.A.nr.213/2023, të datës 09.10.2023 për zbatimin e Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 lidhur me kërkesat e pagës së 13-të të punëtorëve të personelit policor.

Lidhur me faktin nëse e paditura ka pasur mundësi buxhetore, Gjykata në kuptim të nenit 321 par.1 të LPK-së, faktet e ditura botërisht, fakte këto të cilat janë të njohura për rrethin më të gjerë të njerëzve, nuk ekziston nevoja që palët ndërgjyqëse të i provojnë, rrjedhimisht në çështjen konkrete gjykata ka gjetur se sipas Raportit të Auditimit me për Ministrinë e Punëve të Brendshme, i nxjerrur në qershor të vitit 2022, i cili ka vënë në pah se e paditura, gjatë periudhës së vitit 2022, ka pasur buxhet të mangët, ashtu që buxheti për paga dhe mëditje ishte 93,170,639€, prej tyre ishin shpenzuar 91,247,431€, kurse buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 993,438€, ku ulja ishte ndikuar nga vendimet e Qeverisë për shkurtime buxhetore në fund vit, ashtu që shpenzimi i buxhetit për paga dhe mëditje për vitin 2022 ishte 98% e buxhetit final, rrjedhimisht kjo organizatë buxhetore – tani e paditura, asnjëherë nuk ka disponuar me buxhet të mjaftueshëm deri në fund të vitit për të plotësuar nevojat për këtë kategori.

Bazuar në provat e lartcekura është vërtetuar fakti se e paditura si organizatë buxhetore e pavarur është ballafaquar me vështirësi në përmbushjen e të gjitha detyrimeve që kanë të bëjnë me pagat dhe mëditjet e punëtorëve, në këtë kuptim, e paditura ka arritur ta provojë faktin se nuk ka mundësi buxhetore për përmbushjen e obligimit i cili rrjedh nga neni 30 par.2 të Udhëzimit Administrativ me nr.01/2021 për rregullimin e marrëdhënies së punës në Policinë e Kosovës (PK), përkatësisht kompensimin e pagës së 13-të për vitin kalendarik 2022, e cila ka qenë kërkesë shqyrtimi i kësaj çështje kontestimore.

Ligji Nr. 08/L-066 Mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin E Republikës Së Kosovës Për Vitin 2022, në nenin 12 paragrafi 5 dhe 6 ka përcaktuar se “5. Shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere, është i kufizuar në rrethanat kur ka bazë ligjore të qartë sipas këtij ligji, ndonjë ligji tjetër, apo ndonjë akti nënligjor për ato shpenzime, dhe në asnjë mënyrë nuk lejohet që të paguhen shtesa për punonjësit e rregullte nga kjo kategori.”, kurse paragrafi 6 parasheh “6. Shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të shtesave apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat apo dhuratat, duke përjashtuar rimbursimin apo shpenzimet e lejuara për udhëtimet jashtë vendit, sipas legjislacionit përkatës.

Kurse sa i përket linjave tjera buxhetore, sikurse kategoria e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere, Mallra dhe Shërbime, në kuptim të nenit 12 të Ligjit të lart cekur, është përjashtuar mundësia që më të njëjtat të paguhen shtesat, qoftë si kontribute në mall, shujta apo dhurata për punonjësit e rregullt pranë të paditurës, gjegjësisht është përjashtuar mundësia e fuzionimit të linjave buxhetore me njëra tjetrën.

Andaj mbi bazën e lartcekurave, duke pasur parasysh pamundësinë buxhetore të të paditurës, në vlerësimin përfundimtar të Gjykatës gjendja faktike nuk gjen kualifikim të plotë mbi dispozitën e nenit 30 paragrafi 2 të UA 01/2021, me çka u përcaktua pasoja juridike e vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjegjësisht refuzimi i kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e pagës së 13-të për fundvitin 2022.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës, nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore nga nenet 450 lidhur me nenin 463 të LPK-së, pasi që e paditura si palë gjyq fituese nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Bazuar në të lart cekurat, e mbështetur në nenin 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.5689/24, datë 20.12.2024

Gjyqtari
Përparim Zeka

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, përmes kësaj gjykate, për në Gjykatën e Apelit.